

Qershor / June 2010

PERMBAJTJA

Faqe 1

- ATRC trajnon zyrtarët komunalë dhe shoqërinë civile për planifikim kooperues

Faqe 2

- ATRC trajnon anetarët e Kuvendit Komunal të Shtërpcës
- Fëmijet në mbrojtje të mjedisit

Faqe 3

- Shënohet Dita Ndërkombëtare e Mjedisit: “Shumë specie-një planet-një e ardhme”
- Takimi ndërparlamentar Kosovë-Shqipëri
- Tryezë e rumbullakët: “Vepro me seriozitet - parandalo ethet hem-oragjike”

Faqe 4

- Aktivitetet e organizatave grant-marrëse të programit KCSSP

Faqe 5

- Konsulenca - ngritje kapacitetesh
- ATRC monitoron procesin e kthimit të të zhvendosurve nga vendet e treta.

ATRC TRAJNON ZYRTARËT KOMUNALË DHE SHOQËRINË CIVILE PËR PLANIFIKIM KOOPERUES

ATRC gjatë muajit qershor në kuadër të projektit “Zgjidhja e Konfliktit Social” ka mbajtur 5 trajnime dy ditore për “Planifikimin Kooperues”.

Pjesëmarrës në këto trajnime ishin zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e Shoqërisë Civile të komunës së Pejës, Gjakovës, Klinës, Deçanit, Junikut dhe Istogut, të cilët patën rastin të diskutojnë për mundësitë e adresimit dhe zgjidhjes së problemeve të qytetarëve përmes bashkëpunimit me palët në proces.

Trajnimi u fokusua në tri faza kryesore të Planifikimit Kooperues: Ndërtimi i marrëdhënies shumëpalëshe, lehtësimi i procesit të planifikimit kooperues dhe implementimi dhe monitorimi i marrëveshjeve.

ATRC në bashkëpunim me Kuvendet Komunale të 6 komunave të regjionit të Pejës ka filluar gjithashtu të bëjë identifikimin e prioriteteve dhe rekomandimeve të banorëve të këtyre komunave, me qëllim të përfshirjes së tyre në buxhetin komunal për vitin 2011.



Gjatë këtij viti ATRC do të vazhdojë me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe zyrtarët e kuvendit komunal në 6 komunat e regjionit të Pejës, duke synuar kështu rritjen e bashkëpunimit në mes këtyre dy sektorëve.



Informatorit: **The Advocate**, është publikim mujor i ATRC-së, i cili synon të informojë organizatat joqeveritare, donatorët, mediat, përfaqësuesit e institucioneve etj, për aktivitetet e zhvilluara në ATRC dhe nga partnerët e saj. Shpresojmë dhe urojmë që publikimi do të jetë në funksion të informimit dhe koordinimit më të mirë të aktiviteteve në mes ATRC-së dhe organizatave të tjera joqeveritare në Kosovë. Publikimi është bërë i mundur falë gatishmërisë dhe vullnetit të stafit të ATRC-së.

ATRC- TRAJNON ANËTARËT E KUVENDIT KOMUNAL TË SHTËRPCËS

Në kuadër të partneritetit të ATRC-së me Organizatën Gjermane: “Christian Schwarz – Scjiling Project” – CSSP, gjatë këtij muaji në Strugë të Maqedonisë është organizuar trajnimi treditorë për anëtarët e Kuvendit Komunal të Shtërpcës, i përqendruar në Qeverisjen Lokale dhe raportin në mes Komunës dhe qytetarëve.



Fig. 1. Pjesë nga sesioni i trajnimit

Trajnerët e ATRC-së gjatë tri ditëve, i sqaruan anëtarëve të Kuvendit Komunal të Shtërpcës dokumentet bazë të funksionimit të Komunave, si: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose indirekt me komunat, dokumentet tjera komunale të cilat janë obligative për komunat; mënyrat e bashkëpunimit të komunës me qytetarë, raportet komunë—ministri, përgjegjësitë e komunave (vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara) etj.

FËMIJËT NË MBROJTJE TË MJEDISIT

Në kuadër të projektit “Fëmijët në Mbrojtje të Mjedisit”, Advocacy Training and Resource Center (ATRC) ka shpërndarë 60 grante për 60 shkolla fillore në 30 komunat e Kosovës. Granti ka për qëllim vetëdijesimin e fëmijëve për ruajtjen e mjedisit, përkatësisht mbrojtjen e ambientit ku ata mësojnë.

Në kuadër të këtij projekti u mbollën fidane, lule, pisha; pastaj dherat u shndërruan në kopshte gjelbëruese, u vendosën ulëse për nxënës, shporta për hedhurina, e shumë aktivitete të tjera. Projektet janë udhëhequr nga grupi i Ambasadorëve të Vegjël të Mjedisit, të cilët kohë më parë u certifikun si të tillë nga kjo organizatë.

Muharrem Ahmetaj, drejtor i Shkollës Fillore “Idriz Seferi - Bob, Kaçanik, vlerëson se ky projekt ishte shumë i mirëseardhur duke marrë parasysh edhe qëllimin. “Edhe pse me mjete modeste, rëndësia e tij ka qenë e veçantë, sepse i kemi

angazhuar nxënësit së bashku me arsimtarët në aktivitete; nxënësit u motivuan për të ruajtur, klasat, shkollën, ambientin e kështu me radhë.” Z. Ahmetaj konsideron se e veçantë tjetër e këtij projekti ishte edhe angazhimi i KFOR-it Amerikan, i cili njëkohësisht iu bashkangjiti aktivitetit duke inkurajuar nxënësit e angazhuar si dhe ofroi ushqim dhe pije gjatë kësaj kohe.



“Kjo është një ndihmesë mjaft e mirë dhe domethënëse për shkollën, sepse përveç që shkolla mori një pamje më të bukur dhe më të pastër, njëkohësisht nxënësit u motivuan dukshëm për mirëmbajtjen e këtij ambienti edhe në të ardhmen” - thotë Nazmie Hyseni, arsimtare në Shkollën Fillore “Luigj Gurakuqi” në Batllavë të Podujevës.



SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E MJEDISIT

“Shumë specie - një planet - një e ardhme”

Më datë 5 qershor, 2010 për nder të Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, ATRC si partnere implementuese për Kosovë e Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS përmes një numri aktiviteteve shënoi këtë ditë në Prishtinë nën moton: *“Shumë specie. Një Planet. Një e ardhme’- Moto e UNEP”*

E veçanta e kësaj ngjarjeje ishte se Rrjeti Rajonal Mjedisor BELLS në gjashtë qytete të gjashtë shteteve të

Ballkanit Perëndimor (Prishtinë, Tiranë, Shkup, Beograd, Podgoricë, dhe Tuzëll), në po të njëjtën kohë (12 pa 5) përcolli të njëjtin mesazh me përmbajtje të njëjtë tek qytetarët dhe vendimmarrësit e shteteve të rajonit për të *Krijuar politika të gjelbërta për një te ardhme të gjelbër të Ballkanit Perëndimor.*



TAKIM NDËRPARLAMENTAR: KOSOVË – SHQIPËRI

Më datë 7 qershor 2010, ATRC në cilësinë e partnerit implementues për Kosovë të Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS ka organizuar takimin e dytë ndërparlamentar, në mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, respektivisht në mes dy komisioneve funksionale të Mjedisit të dy Kuvendeve.

Delagacioni i Kuvendit të Shqipërisë, i kryesuar nga z. Jemin Xhana, Kryetar i Komisionit për Mjedis në Kuvendin

e Shqipërisë dhe Ardin Turku e Besnik Bare - anëtarë të Komisionit, Edlir Vokopola, koordinator i Iniciativës BELLS në Shqipëri, u pritën në takime të ndara nga: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, nga Kryetari i Komisionit për Mjedis i Kuvendit të Kosovës z. Naser Rugova dhe nga Ministri i Mjedisit z. Mahir Yagcilar



KONFERENCË NDËR-KOMUNALE

“Vepra me seriozitet –Parandalo ethet hemorragjike!”

Më datë 24 Qershor, 2010, ATRC në cilësinë e partnerit implementues për Kosovë të Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS, në Komunën e Malishevës organizoi konferencën ndër-komunale në temën: **“Vepra me seriozitet –Parandalo ethet hemorragjike!”**.

Tryeza kishte për qëllim trajtimin e fenomenit të etheve hemorragjike në regjionin e

Llapushës si dhe hapat që janë ndërmarrë deri me tani për zgjidhjen e këtij problemi dhe sensibilizimin e mëtejme të shoqërisë kosovare,

përkatësisht institucioneve tona vendimmarrëse në rritjen e efikasitetit të shërbimeve dhe metodave zbatuese në parandalimin e etheve hemorragjike të cilat ende po përfundojnë me humbje jetë njerëzish.



AKTIVITETET E ORGANIZATAVE GRANTMARRESE TË PROGRAMIT KCSSP/ USAID/ISC/ATRC-CCSD

KLUBI PËR POLITIKË TË JASHTME - "KOSOVA NË INTERNET "

Klubi për Politikë të Jashtme, përmes projektit "Kosova në internet", përkrahur përmes programit KCSSP (financuar nga USAID, menaxhuar nga ISC dhe administruar nga ATRC-CCSD) synon të shtyjë Qeverinë e Kosovës për nisma konkrete për paraqitjen e Republikës së Kosovës si një entitet të veçantë në internet.

Ky mekanizëm do të shërbejë për të organizuar një grup zyrtarësh, këshilltarësh apo vullnetarësh të cilët do të punojnë në mënyrë të organizuar që Kosova të listohet si një vend apo të paktën si një hyrje e veçantë në përmbajtjen e të gjitha ueb faqeve përkatëse, menu, listë ose një hartë interaktive.

Me 10 qershor, Klubi për Politike të Jashtme ka organizuar konferencën me temë: "Identiteti i Kosovës në internet" qëllimi i së cilës ishte promovimi i Koalicionit për Kosovën në Internet, prezantimi i analizës së politikave për identitetin e Kosovës në internet dhe avokimi tek vendimmarrësit për të gjetur zgjidhje për problemet që kosovarët – individët, kompanitë, organizatat të përballen në hapësirën virtuale.



ORGANIZATA JOQEVERITARE: LIRIA - "NGRITENI ZËRIN TUAJ",

Organizata Joqeveritare: LIRIA nga Istogu, përmes projektit: "Ngriteni zërin tuaj", i përkrahur përmes programit KCSSP (financuar nga USAID, menaxhuar nga ISC dhe administruar nga ATRC-CCSD, synon të bëjë edukimin e qytetarëve për mbrojtje të mjedisit dhe të ushtrojë presion në Kuvendin e Komunës së Istogut që të zbatojë Rregulloret Lokale për Mjedis.

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara për këtë periudhë ka qenë edhe organizimi i një fushate pastrimi të parkut të qytetit të Istogut, e cila është bërë në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës dhe me organizata të tjera joqeveritare nga Istogu.



KONSULENCA – NGRITJE KAPACITETESH

ATRC si pjesë e “Akademisë së Trajnimeve” të programit KCSSP, i cili synon ngritjen e kapaciteteve të organizatave partnere të programit KCSSP, gjatë qershorit 2010 ka ofruar një numër të konsiderueshëm konsulencash për organizatat joqeveritare partnere të ISC/ATRC/CCSD dhe organizata tjera sipas kërkesës. Gjatë muajit qershor, menaxheri i Administratës dhe Financave i ATRC-së ka ofruar 5 konsulencë për 5 organizata joqeveritare; si: CCSD - Mitrovicë,

WCPHR-Fushë Kosovë, DSK - Prishtinë, Birn-Prishtinë dhe Care International-Prishtinë, të cilat janë përqendruar kryesisht në ngritjen e kapaciteteve të përgjegjësve për financa brenda organizatave dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar, duke u përqendruar në përdorimin e formularëve dhe procedurave të parapara me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe në përputhje me kërkesat unike të donatorëve. Kurse procesi i ngritjes së kapaciteteve të organizatave grantmarrëse nga programi KCSSP është i vazhdueshëm dhe i rregullt.

ATRC MONITORON PROCESIN E KTHIMIT TË TË ZHVENDOSURVE NGA VENDET E TRETA

ATRC në partneritet me UNHCR edhe gjatë këtij viti vazhdon me monitorimin e procesit të të kthyrve nga vendet e treta. ATRC aktualisht ka të angazhuar 4 monitorues në Aeroportin e Prishtinës, të cilët në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës, përfaqësinë e UNHCR-it në Kosovë dhe Aeroportin e Prishtinës, intervistojnë dhe grumbullojnë të dhënat e nevojshme për të gjitha rastet e kthimit të Kosovarëve nga vendet e treta, për të gjitha rastet, qoftë kthim vullnetar ose i detyruar. Të dhënat e grumbulluara ATRC në vazhdimësi i përcjell në zyrën qendrore të UNHCR-it.

www.advocacy-center.org

MISIONI I ATRC-së

ATRC është organizatë kosovare, jo-ftimprurëse e cila synon rritjen e pjesëmarrjes së qytetareve në përgjithësi dhe shoqërisë civile në veçanti në proceset vendimmarrëse përmes ofrimit të shërbimeve dhe bashkëpunimit aktiv me palët me interes në vend dhe jashtë tij si një nga kushtet themelore për një shoqëri të zhvilluar dhe demokratike.

PROGRAMET KRYESORE TË ATRC

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit të përgjithshëm organizativ, menaxhimit të projekteve, zhvillim të fushatave të suksesshme të avokimit etj.
2. Programi i administrimit të granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale përmes granteve të vogla kryesisht në fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokojë në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, përmes të cilit ATRC synon të ofrojë informacione në mënyrë elektronike në ueb faqe, në lidhje me diskutimet publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtimet e koalicioneve, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu në kuadër të kësaj komponente ofron librari me 1756 tituj të ndryshëm, si: botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin, analiza, studime, hulumtime dhe dokumente tjera me rëndësi mbi fushëveprimtarinë e organizatave joqeveritare në përgjithësi, të krijuara nga organizata joqeveritare brenda dhe jashtë Kosovës.

ADVOCACY TRAINING & RESOURCE CENTER - ATRC

RR. GAZMEND ZAJMI NR.20 PRISHTINË,

PHONE/FAX: +381(0)38 244810

E-MAIL: info@advocacy-center.org

web page: www.advocacy-center.org